

LEDIA DUSHKU

**POLITIKA AUSTRO-HUNGAREZE DHE KOSOVA
NË VITET E LUFTËS SË PARË BOTËRORE**

**Tipare të politikës së Mbretërisë Dualiste ndaj shqiptarëve
dhe çështjes së bashkimit të tyre kombëtar (1914-1918)**

Shpërthimi i Luftës së Parë Botërore dhe angazhimi i Austro-Hungarisë në të solli takime të rëndësishme të zyrtarëve të lartë austriakë dhe hungarezë për të përshtatur politikën në Ballkan. Politika austro-hungareze ndaj Kosovës kushtëzohej në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qëndrimi që do të mbahej karshi Serbisë, pjesë e së cilës ajo ishte, dhe Shqipërisë, me të cilën shqiptarët e Kosovës aspironin që të bashkoheshin.

Në rrjedhat e Luftës së Parë Botërore në lidhje me këtë qëndrim dallojmë tri faza¹:

Faza e parë përfshin periudhën nga korriku i 1914-ës, kohë kur Austro-Hungaria u angazhua në luftë me Serbinë, deri në maj të 1915-ës, kur Italia hoqi dorë nga asnjësisia dhe u bë pjesë e Antantës, grupimit kundërshtar të Tripalëshit.

Gjatë kësaj faze politika austro-hungareze ndaj Shqipërisë u kushtëzua nga zotimi për një qëndrim të koordinuar, qoftë edhe deklarativ me Italinë. Në shtator 1914, ministri austro-hungarez i Punëve të Jashtme, konti Leopold Berchold shprehej se pavarësisht asnjësisë italiane “... aspiratat tona dhe të Gjermanisë synojnë që të mos ia prishin qejfin asaj”². Fuqitë e Adriatikut vijuan t’i qëndronin Paktit të nëntorit të 1912-ës, të përforcuar në maj të 1913-ës. Pakti i siguronte Italisë

¹ Një trajtim më të detajuar të tipareve të politikës austro-hungareze ndaj shqiptarëve në vitet e Luftës së Parë Botërore shih: Ledia Dushku, “Aspekte të politikës austro-hungareze ndaj Shqipërisë gjatë Luftës së Madhe (1914-1918)” në *Shqipëri-Hungari, dje, sot dhe nesër*, aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare organizuar nga Universiteti i Shkodrës, Shkodër, 2017.

² *Arkivi i Institutit të Historisë-Tiranë* (më tej: *AIH*), A-IV-239, “Protokolle të mbledhjeve të Këshillit të Ministrave të Përbashkët të Monarkisë Austro-Hungareze (Protokolle der Ministerratssitzungen Österreich-Ungarns) (1914-1918)”, fl. 2. Protokollin e mbledhjes së datës 7 shtator 1914.

përkrahjen e Austro-Hungarisë për të bllokuar depërtimin e ndikimeve të tjera në Adriatik dhe e detyronte këtë të fundit të mos ndërmerre asnjë veprim në Ballkan, pa u marrë vesh me Italinë³. Në këtë mënyrë, të dyja fuqitë ndanin ndikimin e tyre edhe në Shqipëri. Në lidhje me kufijtë e shtetit shqiptar, ato vazhdonin t'i konsideronin të pandryshueshëm dhe rrymat eventuale në lidhje me ndryshimin e tyre kishin vetëm karakter të përkohshëm⁴. Në këtë fazë të parë, Austro-Hungaria nuk kishte interes t'i përmbyste vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër për Shqipërinë dhe të bashkonte territoret e Kosovës me “shtetin amë”. Këto vendime ishin për të një pikënisje e suksesshme që në përfundim të Luftës së Madhe ta detyronte Romën të hiqte dorë nga Vlora, të cilën e kishte pushtuar në tetor të 1914-ës, ndonëse në status asnjësie.

Kushtëzimi i dytë në qëndrimin e Vjenës vinte për shkak të luftës me Serbinë. E angazhuar totalisht aty, Austro-Hungaria nuk kishte ndonjë kundërshtim që rolin parësor në Shqipëri ta luante Italia. Pas shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, qëndrimi i kryeministrit austriak, Karl Graf Von Stürgkh dhe ai i homologut të tij hungarez István Tisza, në lidhje me politikën karshi Ballkanit, Shqipërisë dhe Serbisë nuk shfaqte ndryshime thelbësore. Dallimi thelbësor mes tyre ishte evidentuar më herët, më 18 korrik 1914, në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Perandorisë, kur ishte marrë vendimi përfundimtar mbi notën që do t'i dërgohej Serbisë. Kryeministri austriak dhe konti Berchtold e llogaritnin luftën si një “fait accompli”. Të njëjtin mendim me ta kishte edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë austro-hungareze, Franz Conrad von Hötzendorf. I. Tisza, i cili nuk dallohej si mbështetës i krahut të luftës, por njihej si një politikan i qetë, që nuk merrte vendime të përsheptuara të ndikuara nga rrethanat, veçanërisht kur bëhej fjalë për sllavët, të cilët ishin shumicë në Hungari⁵, këmbënguli për aprovimin e ultimatumit ndaj Serbisë vetëm atëherë kur Këshilli i Përbashkët i Ministrave të deklaronte njëzëri se Monarkia Dualiste nuk kishte qëllime për ta skllavëruar

³ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare, 1878-1926*, Tiranë: Albin, 2003, f. 85-86.

⁴ *AIH*, A-IV-239, “Protokolle të mbledhjeve të Këshillit të Ministrave të Përbashkët ...”, fl.2. Protokoll i mbledhjes së datës 7 shtator 1914.

⁵ Graydon A. Tunstall, Jr, “Austria-Hungary”, *The origins of World War I*, Edited by Richard F. Hamilton, Holger H. Herwia, Cambridge University Press, 2003, p. 120.

Serbinë dhe do të kryente vetëm rektifikime të kufirit, të nevojshme nga pikëpamja strategjike⁶.

Ndonëse mendimi i kryeministrit hungarez u shndërrua në vendim, vlera e tij kishte gjasë të mbetej një iluzion. Shpeshherë gjatë debatit ishin shprehur konsiderata se Perandoria Habsburgase nuk do të merrte territore serbe, por pas shpartallimit pjesë të tyre do t'i jepeshin Bullgarisë, Greqisë dhe Shqipërisë. Synimi për ta dobësuar aq shumë Serbinë, sa ajo të mos ishte e rrezikshme për Monarkinë Dualiste, parashihte kështu edhe bashkim të territoreve të Kosovës me “shtetin amë”, Shqipërinë. Vetë ministri i Punëve të Jashtme kishte dyshime nëse kjo e fundit mund të konsiderohej një faktor i sigurt mbështetës për Austro-Hungarinë, dyshime që përligjeshin me propagandat e rrezikshme në mbështetje të Antantës, që gëlonin atje. Ky fakt i jepte shkas atij që në mbarim të luftës, të llogariste mundësinë e aneksimit të një pjese të territoreve serbe me Mbretërinë Dualiste, duke krijuar siguri në kufirin e poshtëm austro-hungarez⁷.

Faza e dytë (maj 1915 - dhjetor 1917)

Më 23 maj 1915, ditën kur Italia i shpalli luftë Austro-Hungarisë, bashkërendimi qoftë edhe deklarativ i tyre për çështjen shqiptare mori fund dhe politika austro-hungareze ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve hyri në një fazë të dytë.

Pas rënies së Beogradit në tetor 1915, forcat ushtarake austro-hungareze vijuan të zgjeronin territoret më në jug dhe në fillim të vitit 1916 pushtuan një pjesë të konsiderueshme të territorit të Kosovës, ndërkohë që vijuan përgatitjet për të hyrë në Shqipëri. Në këtë situatë, çështja shqiptare u rikthye për shqyrtim në nivelet më të larta politike e vendimmarrëse në Vjenë. Më 7 janar 1916 në mbledhjen e posaçme rreth synimeve strategjike në Ballkan, Këshilli i Përbashkët Ministror i Perandorisë Dualiste diskutoi edhe për të ardhmen e Shqipërisë. Nga procesverbal i saj, qartazi kuptohet ekzistenca e dy linjave të ndryshme mendimi: ajo politike që përcaktohej nga Ministria e Punëve të Jashtme

⁶ *AIH*, A-IV-239, “Protokolle të mbledhjeve të Këshillit të Ministrave të Përbashkët ...”, fl. 1. Protokoll i mbledhjes së datës 18 korrik 1914.

⁷ *Po aty*, fl. 1. Protokoll i mbledhjes së datës 19 korrik 1914.

(Ballhausplatz) dhe ajo ushtarake e përfaqësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Ushtrisë Perandorake⁸.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Conrad von Hötzendorf, shprehte bindjen e vazhdueshme se aneksimi i territoreve shqiptare ishte rruga e duhur për të mbrojtur interesat austro-hungareze në Ballkan⁹. Shbërjen e shtetit të pavarur shqiptar, ai e argumentoi me mungesën e homogjenitetit të popullsisë vendase, si në lidhje me gjuhën, origjinën dhe fenë. Sipas tij, një shtet shqiptar "*do të bëhet fushë përballjesh të shteteve të interesuara, sikundër në kohën e principatës [së Vilhelm Wied-it], para së gjithash të Italisë, të cilën nuk mund ta lejojmë që të vendoset përgjithmonë në bregun lindor të Adriatikut.... Por ky pikësynim nuk mund të arrihet pa bashkëpunimin e Bullgarisë dhe të Greqisë*"¹⁰. Me këtë skemë, projekti i shefit të Shtabit të Përgjithshëm mbështeste aneksimin e Shqipërisë së Veriut deri në lumin Mat nga Austro-Hungaria, Shqipëria e Jugut i jepej Greqisë, ndërsa ajo e Mesme përfshirë edhe Durrësin i kalonte Bullgarisë¹¹. Çështja e bashkimit të shqiptarëve të Kosovës me Shqipërinë as që mund të shtrohej për diskutim.

Në dallim, ministri i Punëve të Jashtme, Stephan Burián von Rajecz, mbështeti idenë që jo vetëm të ruhej pavarësia e Shqipërisë, por asaj t'i bashkoheshin përsëri ato krahina, të cilat pas Luftës së Parë Ballkanike u ishin dhënë Serbisë e Malit të Zi.

“Ne nuk duhet të rrëmbelemi nga tentativa e parë që dështoi dhe të mos krijojmë një Shqipëri të pavarur. Shqiptarët gjithmonë e kanë treguar vullnetin se duan të ekzistojnë dhe e kanë vënë në zbatim me këmbënguljen më të madhe... Shteti shqiptar mund të zhvillohet fare mirë po të udhëhiqet drejt dhe këtë punë duhet ta bëjmë ne, duke ushtruar një protektorat efektiv mbi Shqipërinë, jo me qëllim

⁸ Lidhur me këto dy rryma shih Fried, Marvin Benjamin, *Austro-Hungarian War Aims in the Balkans during World War I*, Basingstoke, New York: Palgrave Macmillan, 2014.

⁹ Në lidhje me pikëpamjet e Conrad von Hötzendorf shih: Wolfram Dornik, “Conrad von Hötzendorf and the “Smoking Gun”: A bibliographical examination of responsibility and traditions of violence against civilians in the Habsburg Army”, *Austro-Hungary, the origins and the first year of the World War I, Contemporary Austrian Studies*, vol. 23, Innsbruck University Press, 2014, p. 55-77.

¹⁰ *AIH*, A-IV-239, “Memorandum i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Austro-Hungareze dërguar kryeministrit hungarez”, fl. 25.

¹¹ *Po aty*.

*që ta aneksojmë, por nisur nga dëshira për ta bërë të qëndrojmë me këmbët e veta dhe për ta mbrojtur para çdo ndërhyrjeje të një të treti ... domethënë të themelojmë dhe të konsolidojmë pavarësinë e një shteti, i cili, në përputhje me interesat e tij jetike, t'u shërbejë interesave tona në Ballkan*¹².

Burian-i ishte me këmbë në tokë dhe i ndërgjegjshëm se realizimi i pavarësisë shqiptare nën protektoratin austro-hungarez do të varej nga përfundimi i Luftës Botërore dhe se, Italia nuk do të hiqte dorë vullnetarisht nga pozita e saj në bregun lindor të Adriatikut. Në këtë rast, ministri i Punëve të Jashtme, krahas protektoratit të Shqipërisë, u paraqiti kolegëve të tij në Këshillin e Përbashkët të Ministrave, edhe një alternativë tjetër. Kjo alternativë, e cila kishte të bënte me ndarjen e Shqipërisë, thuajse shkonte në të njëjtën linjë me propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë austro-hungareze. Ndaj pretendimeve bullgare, Burian-i ishte i rezervuar dhe, në dallim nga Conrad, sugjeronte që ato të mos inkurajoheshin në drejtim të Perëndimit¹³.

Mosmarrëveshjet midis diplomatëve dhe ushtarakëve nuk u fashitën në mbledhjen e 7 janarit 1916. Përkundrazi, ato vazhduan me po të njëjtat argumente, deri në dhjetor të po atij viti, ku asnjë palë nuk u tërhoq nga pozitat që mbronte, çka bëri që përballja mes tyre të kthehej më tepër në një betejë prestigji dhe protagonizmi¹⁴. Vetëm në nëntor 1916, diplomacia dhe ushtria të lodhur nga kjo luftë e gjatë nervash ranë dakord për t'u ulur në bisedime për të unifikuar qëndrimin karshi politikës që duhej të ndiqej në Shqipëri. Bisedimet, që u zhvilluan në Teshen, në selinë e Komandës së Përgjithshme, përfunduan më 9 dhjetor 1916 dhe prodhuan një kompromis midis dy qëndrimeve tashmë të njohura të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ushtrisë. Burian-i pranoi që

¹² *Po aty*, "Protokolle të mbledhjeve të Këshillit të Ministrave të Përbashkët të Monarkisë Austro-Hungareze", fl. 12-13. Protokollin e mbledhjes së datës 7 janar 1916.

¹³ *Po aty*, fl. 13.

¹⁴ Për më shumë në lidhje me përplasjen në vijim midis Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ushtrisë Austro-Hungareze shih: Helmut Schwanke, *Zur Geschichte der österreichisch-ungarischen Militärverwaltung in Albanien (1916-1918)*, Tezë doktore, mbrojtur në vitin 1982; Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, vëll. I (1912-1939), Tiranë: Toena, 2013, f. 284-286; Kurt Gostentschinigg, "The different researcher types. Austro-Hungarian Albanology between Politics and Military", në *Relations between Albanias and Austro-Hungary (Austria) by mid XIX century to our days* (International Scientific Conference), Shkup-Prishtinë: Logos-A, 2017, f. 73-86.

autoriteti kryesor për të zbatuar politikën e Vjenës në kohën e luftës në Shqipëri do të ishte Komanda e Korpusit të 19-të të ushtrisë perandorake me seli në qytetin e Shkodrës. Komanda e Përgjithshme pranoi pikëpamjen e Ballhausplatz -it për ndërtimin në të ardhmen, në një kohë të pacaktuar një shtet shqiptar të pavarur nën protektoratin efektiv të Austro-Hungarisë, përmes një procesi edukimi të popullit shqiptar hap pas hapi nga administrata ushtarake¹⁵.

Ndërkohë përgjatë gjysmës së dytë të vitit 1917, në nivelet më të larta ushtarake në Baden si dhe në qeverinë ushtarake austro-hungareze në Serbi dhe Mal të Zi u diskutua çështja e bashkimit të një pjese të territoreve të Kosovës dhe Malit të Zi me Shqipërinë. I ashpër dhe i vendosur ishte qëndrimi i guvernatorit ushtarak të Malit të Zi, Klam Martiniq, i cili vlerësonte se Austro-Hungaria nuk duhej të shpenzonte energji mbi pikëpamjet irredentiste shqiptare, që në krahasim me ato të sllavëve të jugut, ishin dytësore. Sipas tij, Perandoria Habsburgase nuk duhej të bënte përpjekje për bashkimin e shqiptarëve, por duhej të kontribuonte për bashkimin e sllavëve të jugut nën administrimin e saj¹⁶. Pavarësisht sa më sipër, debati mbi çështjen e bashkimit të territoreve të banuara nga shqiptarë në Serbi dhe Mal të Zi me shtetin amë, e shoqëroi strukturën më të lartë politike e ushtarake austro-hungareze edhe në vijim, përgjatë vitit 1918.

Faza e tretë (dhjetor 1917 - shtator 1918)

Kompromisi mes ushtarakëve dhe diplomatëve qëndroi në këmbë deri në fund të vitit 1917, kohë kur komanda e Korpusit të 19-të në Shkodër doli me propozimin për vendosjen në Shqipëri të një qeverie të përgjithshme ushtarake, siç ishte bërë edhe në Serbi. Kështu, gjatë vitit 1918 politika që Austro-Hungaria do të ndiqte ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve hyri në fazën e tretë, tipari dallues i së cilës ishte sërish përplasja midis diplomatëve dhe ushtarakëve. Kjo fazë u kushtëzua prej

¹⁵ *Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSt.A.PA.A.*) në *AIH*, Vj. 12-1215. Raport i përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Alfred Rappapord dërguar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, 15 dhjetor 1916. Raportit i është bashkangjitur teksti i marrëveshjes së Teshenit; P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë...*, f. 286.

¹⁶ *HHSt.A.PA.A.*, në *AIH*, Vj. 27-2-255. Mendim mbi një promemorje të guvernatorit të Malit të Zi, kontit Klam Martiniq, 22 dhjetor 1917.

përkeqësimit të situatës për ushtrinë austro-hungareze, si rrjedhojë e humbjeve në frontet e luftës dhe rritja e pakënaqësisë së shqiptarëve ndaj regjimit të pushtimit.

Ministria e Punëve të Jashtme, ashtu sikurse kishte ndodhur edhe më parë, i qëndroi konsekuente pikëpamjes së saj, se Shqipëria ishte një vend neutral, thuajse aleat, me një shumicë të madhe të popullsisë të lidhur besnikërisht me Austro-Hungarinë. Si e tillë, ajo meritonte të ishte autonome nën protektoratin efektiv të Monarkisë. Ajo vijoi të mbështeste edhe çështjen e bashkimit të territoreve të banuara nga shqiptarë në Serbi dhe Mal të Zi me Shqipërinë.

Në fillim të vitit 1918, komisar civil austro-hungarez në Shkodër, August Kral, mbështetës i bashkimit kombëtar të shqiptarëve, realizoi një takim në Shkodër me kundërshtarin e kësaj pikëpamjeje, drejtuesin e qeverisë së përgjithshme austro-hungareze në Cetinë, Martiniq. Ai u përpoq t'i argumentonte atij rëndësinë politike për realizimin e kësaj platforme, pikërisht në ato momente të cilat Kral i konsideronte të favorshme¹⁷. Bashkimi i Plavës, Gucisë, Hotit, Grudës, Ulqinit, Tivarit, Pejës, Gjakovës si dhe të territoreve të tjera të Kosovës me Shqipërinë, ishte thelbësore sepse një Shqipëri e bashkuar, e fortë dhe e konsoliduar pengonte pretendimet e shteteve ballkanike karshi saj dhe mundësonte realizimin e interesave austro-hungareze për të kontrolluar detin Adriatik¹⁸. Mirëpo, Martiniq vazhdonte ta kundërshtonte fuqishëm idenë e një bashkimi të tillë. Ai i qëndroi me këmbëngulje idesë për bashkimin e sllavëve të jugut në Ballkan, duke kërkuar vëmendje dhe energji maksimale nga Vjena zyrtare për realizimin e tij. Platformën e bashkimit kombëtar të shqiptarëve vijonte ta kundërshtonte edhe kryekomanda e ushtrisë austro-hungareze në Baden.

Ndonëse kundërshtoi disa herë opinionet e ushtarakëve që këmbëngulnin se shqiptarët duhej të trajtoheshin më ashpër sepse ishin mosbesues, kundërshtarë e të pabindur, propozimet e komandës së Korpusit të 19-të në Shkodër për të vendosur në Shqipëri një regjim të hapur pushtimi¹⁹ dhe mbështeti çështjen e bashkimit të tyre në një shtet,

¹⁷ *Po aty*, Vj. 28-2-205. Telegram i August Kral-it për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 15 shkurt 1918.

¹⁸ *Po aty*.

¹⁹ *Po aty*, Vj. 28-6-647. Deklaratë e Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhur me çështjen e vendosjes së një qeverie të përgjithshme ushtarake në Shqipëri, Vjenë, 17 janar 1918; *po aty*, Vj. 28-5-524. Telegram i ministrit të Punëve të Jashtme për

në shtator 1918, Ballhausplatz-i e ndjeu se fundi i luftës ishte i afërt dhe po kështu edhe fati i Perandorisë. Në këto kushte, ai iu nënshtrua Ministrisë së Luftës, duke pranuar se forma e protektoratit mbi Shqipërinë që kishte predikuar prej disa vjetësh do të varej ekskluzivisht prej përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe zhvillimit të bisedimeve të paqes²⁰.

Vjena zyrtare rikonfirmoi realpolitikën dhe qëndrimin e saj se ndonëse dëshironte t'i përgatiste shqiptarët për një vetadministrim të ardhshëm nën protektoratin austro-hungarez, zgjidhjen e çështjes shqiptare në Gadishullin e Ballkanit nuk e shikonte të menjëhershme, por shkallë-shkallë, në përputhje me rrethanat e luftës²¹. Me këtë qëndrim përmbillet edhe faza e tretë e bashkë me të përvijohet edhe fundi i Perandorisë Dualiste.

Pushtimi i Kosovës nga forcat austro-hungareze dhe qëndrimi i shqiptarëve

Ushtria dhe qeveria serbe u detyruan të largohen nga Kosova, menjëherë pasi forcat austro-hungareze dhe gjermane, më 9 tetor 1915 morën Beogradin. Duke nisur nga nëntori, territori i Kosovës u bë arenë e betejave të Luftës së Parë Botërore. Përballeshin mes tyre ushtria gjermane, austro-hungareze, bullgare e serbe, si dhe grupe shqiptarësh, nën drejtimin e nacionalistëve Hasan Prishtina dhe Bajram Curri, të cilët organizonin sulme të armatosura kundër ushtrisë serbe²². Malet e Karadakut, Gryka e Kaçanikut, Pazari i Ri e Mitrovica, ishin korridoret kryesore të depërtimit të forcave ushtarake të Aleancës Qendrore në Kosovë. Përpjekjet e dobëta dhe të paorganizuara mirë të ushtrisë serbe, nuk arritën të kthenin në dorë të tyre Kaçanikun, i cili mbahej i pushtuar nga forcat bullgare. Forcat ushtarake serbe dështuan të rimerrnin këtë

kryekomandantin e ushtrisë, gjeneralin Arc, Vjenë, 30 korrik 1918; P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë...*, f. 288.

²⁰ *Po aty*, Vj. 28-2-232. Direktivat politike për administratën e Shqipërisë, Vjenë, 14 shtator 1918; P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë...*, f. 289.

²¹ *Po aty*, Vj. 28-5-522. Telegram i ministrit të Punëve të Jashtme, kontit Burian për kontin Tratmansdor pranë Kryekomandës së Ushtrisë, Vjenë, 5 qershor 1918.

²² Xheladin Shala, "Tërheqja e ushtrisë serbe nëpër Shqipëri", në *Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave historike*, nr. 19, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1989, f. 222-223.

qytet, por as nuk ishin në gjendje të organizonin qëndresë të fortë në rajone të tjera të Kosovës.²³

Më 13 nëntor 1915, forcat bullgare dhe ato austro-hungareze iu drejtuan Prishtinës, të cilën e morën 10 ditë më pas. Ndërkaq, më 17 nëntor 1915, ushtritë austro-hungareze dhe gjermane përparuan në drejtim të Pazarit të Ri. Pushtimi i Nova Varoshit, Sjenicës e Rashkës, më 20 nëntor 1915, shënoi edhe pushtimin e plotë të kufijve të vjetër (të para vitit 1913) të Serbisë. Gjatë marshimit nga Pazarit të Ri në drejtim të Mitrovicës, Vushtrisë dhe Prishtinës, ushtria austro-hungareze korri suksese të njëpasnjëshme, duke mposhtur ushtrinë serbe dhe duke zënë robër mijëra ushtarë. Trupat austro-hungarezë, më 22 nëntor 1915, pushtuan Mitrovicën dhe sprapsën qëndresën serbe në lumin Sitnica²⁴.

Në rrethana të tilla, kur ushtria serbe ishte e lodhur, e demoralizuar, e goditur nga epidemia e tifos dhe mungesa e ushqimit, qarqet drejtuese ushtarake, më 21 nëntor 1915 urdhëruan largimin nga Kosova. Tre ditë më pas, më 24 nëntor austro-hungarezët morën edhe Mitrovicën, për të vijuar suksesin në Pejë e Gjakovë²⁵. Në përfundim të Prishtinës, në anën e majtë të lumit Sitnica, trupat ushtarakë gjermanë shtrinë autoritetin e tyre, kurse trupat ushtarakë bullgarë pushtuan jugun e Drenicës dhe zotëronin vijën Golesh-Shtime-Jezercë-Luboten. Në vijim, më 20 janar të vitit 1916, ushtria austro-hungareze mori edhe Podgoricën.

Zhvillimi i operacioneve luftarake në vjeshtën dhe dimrin e 1915-ës në Kosovë rezultoi të ishte i rëndësishëm për orientimin dhe pozicionimin e shqiptarëve në lidhje me Fuqitë e Tripalëshit. Elita politike shqiptare, në kushtet kur fundi i sundimit serbo-malazez në Kosovë ishte i pashmangshëm, e konsideroi të vlefshme demonstrimin e simpatisë për Tripalëshin në përgjithësi dhe Perandorinë Dualiste në veçanti. Nga ana tjetër, perceptimi i shqiptarëve për Perandorinë Dualiste,

²³ Gjeneral G. Phillips dhe Komiteti "Mbrotja Kombëtare e Kosovës", *Dokumente historike nga Arkivat Britanike 1913-1921*, përgatitur për botim nga Ethem Çeku dhe Bejtullah Destani, Instituti i Çështjeve Kombëtare (Tiranë) dhe Qendra për Studime Shqiptare (Londër), 2015, f. 174. Raport i gjeneralit Phillips nga Shkodra dërguar Zyrës së Luftës, Shkodër, 7 dhjetor 1915.

²⁴ Fitim Rifati, *Kosova gjatë Luftës së Parë Botërore*, tezë doktorature mbrojtur në Institutin e Historisë, pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, maj 2018, e pabotuar.

https://drive.google.com/file/d/1s8QRznOOupkrtNrIru_TUpNhOJtzzPjH/view

²⁵ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. I, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2017, f. 491.

veçanërisht pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë ravijëzohej nga tone tejet pozitive dhe unike, që merrnin shkas nga qëndrimi mbështetës i diplomacisë austro-hungareze ndaj çështjes shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912-1913). Ky qëndrim kishte ndikuar në perceptimin e shqiptarëve, të cilët e konsideronin Perandorinë e Habsburgëve, si “*mirëbërësen*”, “*krijuese*” dhe “*mbrojtësen*” e tyre²⁶. Si rrjedhojë, shpeshherë hyrja e detashmenteve austro-hungareze në Shqipëri e Kosovë, ishte pa luftë dhe pritja e vendasve miqësore. Tashmë, Perandoria Dualiste konsiderohej prej tyre si *çlirimtarja* nga pushtuesit serbë, ushtarët e së cilës “*po derdhin gjakun për shpëtimin e liriën t’onë, tue u bamun gati me u shërbye besnikisht mbas fuqiës t’onë e mbas urdhënavet qi do të marrim*”²⁷. Në këtë kontekst, veçori dalluese e pushtimit të qyteteve të Kosovës nga ana e forcave austro-hungareze, gjermane e bullgare, ishte pjesëmarrja e grupeve shqiptare, të cilat në jo pak raste i paraprinë ushtrive të Tripalëshit. I tillë ishte rasti i Bajram Currit, i cili u fut në Gjakovë dhe në Pejë para forcave ushtarake të Aleancës Qendrore. Po ashtu, shqiptarët ishin të parët që çliruan Shkupin, Prizrenin dhe Gjakovën, kurse pas tyre futeshin forcat e Aleancës Qendrore²⁸.

Krijimi i zonës austro-hungareze: marrëveshja austro-hungaro-bullgare për administrimin e Kosovës

Pushtimi i Kosovës nga Austro-Hungaria dhe Bullgaria u shoqërua me ndarjen e territorit në dy zona pushtimi. Sipas Konventës së arritur më 6 shtator 1915, zona austro-hungareze dhe ajo bullgare u krijuan përkatësisht në të majtë dhe në të djathtë të vijës Podujevë-Prishtinë-Lipjan-Rahovec-Prizren. Zona austro-hungareze përfshiu gjithë territoret

²⁶ Për më shumë shih: L. Dushku, “Perceptimi dhe realiteti: Shqiptarët dhe autoritetet austro-hungareze përgjatë vitit 1916”, Aktet e konferencës ndërkombëtare *Austro-Hungaria dhe Shqipëria 1916-1918*, organizuar nga Muzeu Historik Kombëtar dhe Ambasada e Austrisë në Tiranë, më 26-27 janar 2017 (në proces botimi).

²⁷ Lef Nosi, *Dokumente historike për t’i shërbyer historiës tonë kombëtare*, Botim i dytë, përgatitja për botim dhe redaktimi shkencor nga Marenglen Verli dhe Ferit Duka, Tiranë: Nënë Tereza, 2007, f. 245-246. Thirrje drejtuar shqiptarëve nga Preng Bibdoda, Seid Pasha, Fejzi Alizoti, Luigj Gurakuqi, Aqif Pashë [Elbasani], Cetinë, 28 janar 1916; *HHS.A.P.A.A*, në *AIH*, Vj.26-7-716, nr.193/P. Ekstrakt i raportit nga Shkodra dërguar MPJ në Vjenë, 30 nëntor 1916.

²⁸ “Shqiptarët” në *Dielli*, Boston, Mass., Wednesday, January 19, 1916, f. 2.

në veri të vijës së përmendur, në kuadrin e të cilave ndodheshin qytetet e Mitrovicës, Vushtrisë, Klinës, Istogut, Pejës, Gjakovës, Zhurit, Plavës e Gucisë, Ulqinit, Tivarit.

Ndarja përfundimtare midis dy zonave u përcaktua me marrëveshjen dypalëshe të 1 prillit 1916, e cila mbeti në fuqi deri më 29 shtator 1918, kur Bullgaria kapitulloi dhe doli nga lufta²⁹. Sipas marrëveshjes së prillit, vija e ndarjes administrative në Kosovë, niste nga rrjedha e lumit Llap e deri në grykëderdhjen e lumit Sitnicë, vazhdonte 1,5 km në juglindje të Mikushnicës drejt malit Çiçavicë, shkonte deri te derdhja e kroit të Rakoshit në Klinë dhe vazhdonte në skaj të lumit Drin, në kufijtë e vjetër serbo-malazezë deri në juglindje të Gjakovës. Rrjedhimisht, Podujeva, Prishtina, Drenica e Sipërme, Gjilani, Kamenica, Vitia, Rahoveci, Prizreni, Suhareka, Lipjani, Shtimja, Ferizaji e Kaçaniku, i takonin zonës së pushtimit dhe administrimit bullgar, kurse Mitrovica, Vushtria, Drenica e Poshtme, Istogu, Klina, Peja, Deçani, Juniku, Gjakova dhe Zhuri, i takonin zonës së pushtimit dhe administrimit austro-hungarez. Sipas marrëveshjes, trupat e secilës palë do të tërhiqeshin brenda zonave përkatëse, duke konkretizuar vijën e miratuar të demarkacionit. Përballë këmbënguljes së Mbretit bullgar dhe për të shmangur një konflikt të mundshëm, austriakët toleruan lënien e Prishtinës dhe të Prizrenit brenda zonës bullgare.

Krahas delimitimit, marrëveshja rregulloi edhe disa çështje të karakterit ushtarak dhe ekonomik, që lidheshin me transportin. Austro-Hungaria siguroi në zonën bullgare të drejtën e përdorimit të hekurudhës Kaçanik-Ferizaj-Fushë Kosovë-Mitrovicë, si dhe të rrugës nga Ferizaj, në Prizren e mandej në Shqipëri, si dhe të rrugës në drejtim të Prishtinës e Mitrovicës³⁰. Por me marrëveshjen e prillit 1916, Austro-Hungaria hoqi dorë nga projekti i diplomacisë që, në kuadër të Shqipërisë, të përfshiheshin sa më shumë territore etnike shqiptare. Ky qëndrim vinte nën arsyetimin e rrezikimit të qëndrueshmërisë së Aleancës Qendrore, si rrjedhojë e kërcënimit bullgar për largimin nga Aleanca Tripalëshe. Efektet e kërcënimit bullgar u ndjenë edhe në vazhdimësi, duke ndikuar dhe modeluar një qëndrim më të matur dhe të rezervuar të shtetit habsburgas karshi një Shqipërie të pavarur e autonome, të bashkuar në

²⁹ Zhivko Avramovski, "Konflikti austro-hungarezo-bullgar rreth Kosovës dhe synimet e Bullgarisë për të dalë në detin Adriatik përmes Shqipërisë (1915-1916)", në *Gjurmime albanologjike*, seria III, 1973, Prishtinë: 1975, f. 102; *Historia e shqiptarëve ...*, f. 492.

³⁰ *Historia e shqiptarëve ...*, f. 494.

pjesën më të madhe të viseve etnike shqiptare. Sakaq, si rrjedhojë e marrëveshjes së prillit 1916, Bullgaria realizoi në mënyrë të kënaqshme aspiratat ekspansioniste në drejtim të Kosovës dhe territoreve në jug të saj.

Organizimi administrativ i zonës austro-hungareze të pushtimit

Në kuadrin e marrëveshjes me Bullgarinë, Austro-Hungaria realizoi ndarjen administrative dhe organizoi nga pikëpamja ushtarake dhe civile zonën përkatëse të pushtimit. Specifikë ishte se territori i Kosovës u administrua nga tre drejtime: nga Shqipëria, nga Serbia dhe Mali i Zi, zona këto të pushtuara tashmë nga Austro-Hungaria. Territori i Kosovës i administruar nga Shkodra ishte pjesë e njësisë administrative të qarkut me numër II. Përfshinte malësinë katolike midis kufirit malazez dhe Drinit, me krahinat e Krasniqes, Gashit, Bytyçit dhe Malësinë e Gjakovës. Ndërsa vendbanimet e Hasit dhe të Malësisë së Gjakovës me rrethet Lumë, Tejdrinë, Mal i Zi, Gorë dhe Dibër e Poshtme (Peshkopi) përfshiheshin në qarkun numër VI, qendra e të cilit ishte Kulla e Lumës e më vonë Zhuri. Nën qeverinë e Përgjithshme Ushtarake austro-hungareze të Serbisë, me qendër në Beograd, u përfshinë rrethet e Mitrovicës, Vushtrisë dhe Drenicës së Poshtme (Skënderajt), të cilat së bashku formonin njësinë administrative të njohur si qarku i Mitrovicës. Ndërsa rrethi i Pejës, Gjakovës dhe Istogut, të organizuara në njësinë administrative të njohur si qarku i Pejës administroheshin nga qeveria e Përgjithshme Ushtarake e Malit të Zi, me qendër në Cetinë³¹.

Në hierarkinë e administratës austro-hungareze në Kosovë pushtetin më të lartë e kishin guvernatorët ushtarakë në Shkodër, Cetinë e Beograd, të cilët vepronin sipas direktivave të Ministrisë së Luftës përkatësisht Komandës së Përgjithshme ushtarake austro-hungareze. Në rastin e territorit që varej nga Shkodra, krahas guvernatorit ushtarak vepronte edhe përfaqësuesi politiko-diplomatik, i cili i raportonte Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë. Në krye të çdo qarku qëndronte komandanti, përgjegjës për zbatimin e politikës okupuese pas guvernatorit, i cili asistojë nga një numër të caktuar oficerësh. Vartës të

³¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Periudha e Pavarësisë (28 nëntor 1912-7 prill 1939), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2008, f. 437.

tyre ishin komandantët e stacioneve apo rretheve, të cilët kryenin funksione administrative ushtarake dhe civile, në nivel më të ulët administrativ. Në të gjitha rrethet u emëruan nënprefektë e kryetarë të komunave, të cilët kryenin funksione nën mbikëqyrjen e komandantëve të stacioneve. Në nënprefektura u hapën gjykata vendëse, zyra tatimi, zyra kadastrorë dhe zyra të gjendjes civile. Komandat ushtarake zotëronin pushtetin ushtarak, administrativ e gjyqësor edhe nëpër qarqe e rrethe, ndërsa pushteti civil shtrihej nëpër komuna. Trupa administrative e komunave përbëhej nga kryetari dhe sekretari i tij. Funksiononte edhe Këshilli i Komunës, i cili përbëhej nga të zgjedhur që, së bashku me kryetarin dhe sekretarin, mbledheshin një herë në javë, për diskutimin e çështjeve që shqetësonin vendin. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit zgjidheshin nga bashkësia lokale, i tërë stafi i komunave paguhej për funksionet dhe shërbimet që kryente në kuadër të administratës austro-hungareze. Përmes kësaj skeme dhe strukture administrative, qarqet administrative austro-hungareze synonin që nëpërmjet zhvillimit administrativ, ekonomik, shoqëror dhe kulturo-arsimor të këtyre territoreve, të siguronin suksesin edhe në aspektin ushtarak.³² Ndërkohë që jeta e përditshme ishte thuajse tërësisht e drejtuar dhe administruar nga pushtuesit, përfshirë masat sanitare dhe shpërndarjen e ushqimit³³.

Në kuadër të administratës civile austro-hungareze u emëruan edhe nëpunës vendas, kryesisht nëpër komuna, pavarësisht se një pjesë e tyre shfaqnin mungesë të njohurive, nivel të ulët kulture dhe mungesë të gjuhës gjermane. Në të shumtën e rasteve kjo ishte e lidhur drejtpërsëdrejti me përpjekjet për t'i shfrytëzuar territoret e pushtuara në mënyrë sa më efikase dhe për të angazhuar sa më pak ushtarë që të ishte e mundur në administrimin e tyre. Në funksion të qetësimit të situatës, në rastin e shqiptarëve, të cilët ishin në shumicë myslimanë, ky proces tejkaloi objektivin. Rregulloret e lëshuara në jo pak raste krijuan dallime mes popullsisë “besnike”, siç ishin shqiptarët e myslimanët dhe sllavëve ortodoksë, të konsideruar si “armiq”. Madje, ndonjëherë këto rregullore injoruan edhe dispozitat e Hagës³⁴.

³² Mariano San Nicolo, “Administrimi i Shqipërisë nga ana e trupave austro-hungareze”, në *AIH*, A-IV-73, f. 9-10.

³³ Tamara Cheer, “Politika okupuese habsburgase ndaj shqiptarëve, myslimanëve dhe turqve në Mal të Zi dhe Serbi gjatë Luftës së Parë Botërore”, në *Albanologji* 6, 2015, vëll. II, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2016, f. 233.

³⁴ *Po aty*, f. 230.

Zgjedhjen dhe emërimin e nëpunësve vendorë në administratë, me dekret e bënte komandanti i korpusit. Kështu, në rrethin e Gorës funksionin e prefektit e kryente Mullah Arifi. Kryetar i rrethit të Pejës u emërua Nexhip Basha, një personalitet me përvojë administrative. Në kuadër të qarkut VI të Zhurit, mandatin e nënprefektit e kryente Hysni Curri, nipi i nacionalistit Bajram Curri. Kryetar i qarkut të Mitrovicës u emërua Dervish Mitrovica, kurse kryetar i rrethit të Mitrovicës u emërua Fadil Shefkiu, i cili u zëvendësua më pas nga Nexhip e Ferhat Draga. Në administratë u emëruan edhe shumë nëpunës të tjerë shqiptarë. Në Vushtri, prefekt i rrethit u caktua Izet Badivuku, personalitet me emër i asaj zone³⁵.

Administrimi i zonës austro-hungareze në Kosovë

Funksionet kryesore të regjimit pushtues në Kosovë, krahas ruajtjes së rendit dhe të qetësisë, kishin të bënin edhe me sigurimin dhe furnizimin e linjave të para të frontit me rekrutë dhe, shfrytëzimin e sa më shumë të ishte e mundur të burimeve të vendit të okupuar për qëllime të luftës. Për realizimin e tyre, komanda e lartë ishte e vendosur t'i fitonte zemrat e mendjet e popullatës dhe t'i bindte ato se trajtimi i tyre ishte më i miri³⁶. Një prej veprimeve të para ishte lirimi i të burgosurve dhe robërve të luftës në Serbi, pjesë e të cilëve ishin edhe shqiptarët e Kosovës³⁷, për të vijuar me dërgimin e qindra vagonëve me misër nga Rumania për familjet e varfëra³⁸ dhe shpalljen e besës së përgjithshme të popullsisë³⁹. Nga ana tjetër, për të gjitha regjimet okupuese mbështetja nga strukturat e besuara të popullsisë vështrohej si një faktor shumë i rëndësishëm në realizimin e objektivave të tyre. Favorizimi nuk kishte të bënte vetëm me shpresën që njerëzit të bëheshin besnikë, por që besnikët të mbeteshin të tillë sikurse evidentohet në një raport në lidhje me restaurimin e xhamive të Gjakovës e Pejës: “*edhe debati për rinovimin e*

³⁵ Një pasqyrë e plotë e emërimeve të shqiptarëve në administratë gjendet tek: F. Rifati, *Kosova gjatë Luftës së Parë Botërore ...*, tezë doktorature (e pabotuar).

³⁶ Tamara Cheer, “Politika okupuese habsburgase ndaj shqiptarëve ...”, f. 225.

³⁷ *Po aty*; “Myslmanët, qi qenë jesirë me ushtarë serb, shkuen në vende të veta”, në *Vëllazënia*, nr.10, Vjenë, 30 prill 1916, f. 1.

³⁸ *HSt.A.P.A.A.*, në *AIH*, Vj. 26-14-1478. Telegram i konsullit austro-hungarez nga Shkodra dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Shkodër, 8 maj 1916.

³⁹ *Po aty*, Vj. 26-9-974. Telegram i konsullit austro-hungarez, Kral, për eprorët e tij në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Shkodër, 23 shkurt 1916.

*xhamive kishte përshtypje të mirë ndaj myslimanëve [...] pasi 80 % e popullatës është e besimit islam. Efekti i përfitimit politik përmes një veprimi të tillë është i pamohueshëm*⁴⁰. Në funksion të sa më sipër u përvijua edhe politika në terren.

Rekrutimi ushtarak

Në kushte lufte, me qëllim furnizimin me rekrutë të linjave të frontit, rekrutimi ushtarak konsiderohet një proces i pashmangshëm. Ndonëse rekrutët shqiptarë, pjesë e ushtrisë serbe u liruan nga ushtria austro-hungareze fill pas hyrjes së tyre në Kosovë, qëndrimi i tyre në shtëpi nuk zgjati shumë. Shpejt ata u ripërfshinë në rekrutim.

Procesi i rekrutimit të shqiptarëve u kushtëzua nga marrëveshja serbo-osmane e marsit të vitit 1914, sipas së cilës popullsia myslimane në Serbi, për tre vite gëzonte statusin e shtetësisë osmane. Si rrjedhojë, meshkujt shqiptarë të besimit mysliman që ishte e aftë për luftë, do të duhej të rekrutohej në radhët e ushtrisë së Perandorisë Osmane.

Rrethet diplomatike në Vjenë, ndonëse kuptonin peshën specifike të aleancës me Perandorinë Osmane kundër aleatëve të Antantës, i trembeshin ndikimit eventual osman në zbehjen e ndjenjave kombëtare të shqiptarëve të besimit mysliman. Trashëgimia osmane prezente ndër ta, nuk mund të zhdukej me një të rënë të lapsit. Në këtë situatë diplomacia vjeneze, dëshironte që rekrutimi të realizohej i zhveshur nga çdo element që godiste formësimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve myslimanë, duke dashur kështu të shmangnin rijetësimin e idesë së sovranitetit osman. Respektimi i këtyre parimeve nga Komanda Ushtarake osmane, për diplomacinë austro-hungareze nënkuptonte miratimin e plotë të angazhimit të vullnetarëve shqiptarë, nën drejtimin e oficerëve austro-hungarezë dhe shqiptarë, në reparte dhe nënreparte shqiptare në frontin e Galicisë. Por, Ministria e Luftës insistoi të shtonte radhët e ushtrive të Aleancës Qendrore me vullnetarë e ushtarë, në secilin front të luftës kundër forcave ushtarake të Antantës. Si rrjedhojë, autoritetet austro-hungareze në Kosovë nuk e përfillën qëndrimin e rretheve diplomatike dhe lejuan rekrutimin e shqiptarëve myslimanë në ushtrinë osmane nën flamurin osman. Vetëm gjatë vitit 1916 nga zona austro-hungareze në

⁴⁰ T. Cheer, "Politika okupuese habsburgase ndaj shqiptarëve ...", f. 229

Kosovë u rekrutuan brenda një kohe të shkurtër 4.500 vetë për regjimentin e ruajtjes së depove të Koorparmatës XV osmane⁴¹.

Procesi i rekrutimit të shqiptarëve në radhët e ushtrisë osmane në frontin e Galicisë, për shkak të nevojave numerike-ushtarake që kërkonte fronti i luftës, vijoi edhe gjatë vitit 1917. Ky veprim i detyrohet marrëveshjes së arritur midis Ministrisë së Luftës dhe asaj të Punëve të Jashtme, sipas së cilës çështja e përkatësisë shtetërore të myslimanëve të Serbisë nën Austro-Hungarinë, të rekrutuar në radhët e Koorparmatës XV osmane dhe për të kryer shërbime të tjera ushtarake në Stamboll, qëndronte e hapur derisa të mbaronte Lufta e Parë Botërore.⁴² Për pasojë, rekrutimi i shqiptarëve myslimanë të Kosovës në radhët e Koorparmatës XV osmane vijoi sipas dëshirës së Perandorisë Osmane⁴³.

Ndërkohë, shqiptarët u rekrutuan edhe në radhët e ushtrisë austro-hungareze. Pavarësisht kundërthënieve të herëpashershme mes diplomacisë dhe ushtrisë austro-hungareze, ky proces nuk u ndërpre deri në fund të Luftës së Parë Botërore. Pjesë e ushtrisë austro-hungareze ishin edhe vullnetarët shqiptarë, për rekrutimin e të cilëve luajtën rol nacionalistë shqiptarë me reputacion, si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Ferhat Draga. Përmes propagandës kombëtare e fetare dhe ofertave materiale, ata regjistruan forca vullnetarësh në radhët e shqiptarëve. Kështu, Hasan Prishtina organizoi rekrutimin e 2.000 vullnetarëve shqiptarë, ndërsa Ferhat Draga ndihmoi në rekrutimin e 1.000 të tjerëve, të cilët u dërguan në frontin lindor të Austro-Hungarisë, ose iu bashkuan trupave aleatë osmanë⁴⁴. Për bashkëpunimin e ofruar, disa prej tyre morën edhe detyra në pushtetin vendor. Madje, Dervish Mitrovica që luajti rol në formimin e batalionit shqiptar të Mitrovicës, përveç detyrës së kryetarit të komunës, iu dha dhe grada ushtarake e majorit të ushtrisë së Austro-Hungarisë⁴⁵.

⁴¹ *HHSSt.A.P.A.A.*, në *AIH*, Vj. 27-3-358. Njoftim nga Baden për ministrin e Jashtëm, kontit Czernin, Baden, 26 janar 1917 (transmetohet raporti administrativ i qeverisë së përgjithshme ushtarake në Beograd mbi rekrutimin e shqiptarëve).

⁴² *Po aty*, Vj.27-82. Njoftim nga Baden për ministrin e Jashtëm, kontit Czernin, Baden, 11 maj 1917.

⁴³ Për më shumë në lidhje me procesin e rekrutimit të shqiptarëve myslimanë në radhët e ushtrisë osmane dhe ndikimin e këtij procesi në emigrimin e popullsisë shih: F. Rifati, *Kosova gjatë Luftës së Parë Botërore ...*, tezë doktorature, e pabotuar.

⁴⁴ *Historia e Popullit Shqiptar...*, f. 440.

⁴⁵ *Po aty*.

Aspekte të politikës ekonomike

Situata ekonomike në zonën e pushtimit dhe administrimit austro-hungarez në Kosovë, në vitet e Luftës së Parë Botërore karakterizohet nga ritme zhvillimi të ngadalshme, projekte infrastrukturore të shumta, në shumicë të porealizueshme, plane konkrete për shfrytëzimin e pasurive natyrore, të produkteve bujqësore e blegtorale në interes të luftës, pa anashkaluar edhe përpjekjet për të shmangur varfërinë dhe zinë e bukës në Kosovë.

Me rëndësi u konsideruan investimet në infrastrukturën e komunikacionit rrugor; në shëndetësi (spitalet, injeksionet profilaktike, mjetet e dezinfektimit); në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të kultit: ndërtim të godinave shtetërore; shfrytëzimi sistematik i pyjeve përmes një ndërmarrjeje austro-hungareze dhe i pasurive ujore me qëllim final ndërtimin e hidrocentraleve; importimin e veglave moderne ekonomike.

Me fokus ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, prerjen e drurëve për nevojat e ushtrisë, u organizua puna e detyruar. Nën drejtimin e inxhinierëve austro-hungarezë, meshkujt shqiptarë morën pjesë në projektet e infrastrukturës rrugore. Që prej gushtit 1917, rekrutimi i tyre, përgjithësisht bëhej në përputhje me Rregulloren e Hagës mbi luftën tokësore, duke mos cenuar personat që ishin në marrëdhënie pune. Por, autoritetet e administratës austro-hungareze akuzonin një pjesë të shqiptarëve se nuk ishin në gjendje t'i përgjigjeshin pozitivisht thirrjeve për punë në zhvillimin e vendit, sikurse ishte hapja e rrugëve. Arroganca dhe indiferenca e shqiptarëve, sipas vlerësimeve të administratës austro-hungareze, pengonte zhvillimin e përgjithshëm të tyre si dhe pamundësonte realizimin e projekteve ekonomike austro-hungareze për shqiptarët.⁴⁶

Sipas studiueses austriake Tamara Cheer, për popullsinë shqiptare, krahasuar me atë sllave të besimit ortodoks, në fushën ekonomike zbatohet një trajtim i favorizuar⁴⁷. Kjo natyrë trajtimi që i rezervohej edhe popullsisë të tjera të besimit mysliman, nuk përfshinte vetëm sasinë e punës ditore që jepej nga komandantët lokalë, por fillonte me instancën më të lartë të urdhrave të dhëna nga qeveria okupatore në lidhje me trajtimin e popullatës së përgjithshme.

⁴⁶ *HHSt.A.P.A.A.*, në *AIH*, Vj.26-7-719. Aneks i Kryekomandës së ushtrisë, 20 maj 1916.

⁴⁷ T. Cheer, "Politika okupuese habsburgase ndaj shqiptarëve ...", f. 226-227.

Regjimi pushtues impononte dënime të rënda, ligje lufte, mbajtje peng dhe punë të detyruar. Në maj 1916 u lëshua urdhri që theksonte se nëse një qytetar i Serbisë apo i Malit të Zi nuk i respektonte urdhrat, atëherë e gjithë popullsia e fshatit të personit në fjalë, e aftë për shërbim ushtarak, do të rekrutohet dhe do të përdoret për punë të detyruar. Përjashtimin e vetëm nga ky dënim e përfitonte “*popullata besnike myslimane dhe shqiptare*”. Urdhri vijues grumbullonte pa mëshirë gjithë mallrat për të cilat ushtria kishte nevojë. Sërish prej tij përjashtohej vetëm popullata “*besnike*” (shqiptarët, myslimanët dhe turqit), të cilët “*duhet të trajtohen dhe konsiderohen njerëzishëm*”. Sipas shefit të qeverisë së Beogradit, ata shmangeshin për dy arsye: për shkak të kapacitetit të ulët të prodhimit dhe për të mos humbur politikisht këndvështrimin pozitiv që ata kishin për Perandorinë Dualiste⁴⁸.

Pavarësisht përpjekjeve për të ndërgjegjësuar popullsinë shqiptare për të paguar taksat të pandryshuara nga periudha osmane, hartimit të rregulloreve për regjistrimin e gjësë së gjallë dhe vjeljen e xhelepit, si dhe një rregullore për të ndaluar fenomenin e kontrabandës në tregti, administrata austro-hungareze nuk arriti të mblidhte tatimet dhe taksat në masë të dëshirueshme. Pati zona malore, si ajo e Zhurit, ku ky detyrim nuk u pagua asnjëherë⁴⁹. Përpjekje pati edhe për modernizimin e disa prej degëve të ekonomisë bujqësore. Për të realizuar mbjelljet e pranverës dhe për të organizuar parcelat në mënyrë profesionale, u organizuan kurse të posaçme⁵⁰. Por dokumentacioni arkivor asutro-hungarez tregon se interesimi i bujkut shqiptar për avancimin e metodave prodhuese në bujqësi, nuk ishte në nivele të dëshirueshme.

Megjithatë, administrata austro-hungareze arriti që t'i shfrytëzonte burimet ekonomike të Kosovës kryesisht nëpërmjet shkëmbimit të mallrave, blerjeve me çmime të ulëta, të përcaktuara prej saj dhe jo prej tregut si edhe detyrimin për të bërë shitblerje vetëm me korona. Edhe në listën e rekuizimeve u futën një gamë e gjerë produktesh bujqësore dhe blektorale, metalet me ngjyrë, ndonëse në veprimet për mbledhjen e tyre u treguan të kujdesshëm dhe tolerantë⁵¹.

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ *HHSSt.A.PA.A*, në *AIH*, Vj.27-5-546. Raport i Kral-it nga Shkodra dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Shkodër, 26 shtator 1917.

⁵⁰ *Po aty*, Vj.28-5-542. Raport i Kral-it nga Shkodra për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Shkodër, 22 qershor 1918.

⁵¹ *Historia e shqiptarëve...*, f. 503.

Autonomia kulturore-kombëtare e shqiptarëve

Në funksion të ruajtjes së simpatisë së shqiptarëve për austro-hungarezët, autoritetet ushtarake, nën nxitjen dhe imponimin e rretheve diplomatike, aplikuan një politikë në dobi të autonomisë kulturore-kombëtare. Kjo politikë ishte më e dukshme veçanërisht në territorin e kufijve administrativë të korpusit të Komandës XIX të Shqipërisë. Toleranca u shpreh në përdorimin e simboleve kombëtare të shqiptarëve, ku veçohet përdorimi i shqiponjës shqiptare si stemë në administratën e qarqeve të Gorës e më pas Zhurit. Ky simbol u lejua të përdorej edhe në vise të tjera të Kosovës nën Austro-Hungarinë, veçanërisht në institucionet arsimore.⁵² Gjithashtu, gjuha shqipe u lejua të përdorej në administratë krahas asaj gjermane.

Në aspektin e autonomisë kulturore-kombëtare u vendos ushtrimi i kompetencave të komisarit civil të vendit pranë Komandës së Korpusit të 19-të në Shkodër. Në këtë post u emërua diplomati i karrierës dhe njohësi shumë i mirë i shqiptarëve dhe botëkuptimit të tyre, konsulli i Përgjithshëm i Shkodrës, August Ritter von Kral⁵³. Atij iu la dorë më e lirë në organizimin e administratës së përgjithshme, në fushën e financës, të drejtësisë dhe të arsimit. Vendimtare në këtë drejtim ishte kompetenca që iu akordua atij në emërimin e personelit të zyrave shqiptare, pavarësisht se të gjitha këto lëvizje do të duhej të merrnin miratimin e komandës ushtarake austro-hungareze.

Sipas skicës së përgatitur prej konsullit Kral, për mënyrën se si duhej të administroheshin territoret shqiptare, ndër 5 pikësnyimet e administratës austro-hungareze në Shqipëri, dy prej tyre kishin të bënin me ngritjen kulturore të vendit dhe të popullsisë dhe me edukimin e shqiptarëve me vetëdije nacionale unike, për t'i bërë të aftë për vetëqeverimin e ardhshëm të vendit të tyre⁵⁴.

⁵² F. Rifati, *Kosova gjatë Luftës së Parë Botërore ...*, tezë doktrature (e pabotuar).

⁵³ Një trajtim i plotë i veprimtarisë së konsullit August Kral gjendet tek: Kurt Gostentschnigg, "August Ritter von Kral. Aktori kryesor i Austro-Hungarisë në trojet shqiptare", në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2016, f. 49-72.

⁵⁴ Tre synimet e tjera të administratës austro-hungareze në Shqipëri kishin të bënin me sigurimin e operacioneve ushtarake, ruajtjen e interesave politike dhe ekonomike të Monarkisë, duke përjashtuar çdo influencë armike dhe sigurimin e jetës dhe të pasurisë. *HHSt.A.P.A.A.*, në *AIH*, Vj. 26-18-1826. Njoftim i ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për kontin Turn, Vjenë, 3 mars 1916. Transmetohet

Për realizimin e këtyre pikësnyimeve, një rol vendimtar konsiderohej të kishte aspekti arsimor dhe pikërisht, kultivimi sa më mirë i gjuhës së vendit, përjashtimi i gjuhëve të huaja, sidomos i italishtes, evitimi i tentativave sllavizuese për gjuhën shqipe dhe shkollimi i të rinjve shqiptarë në shkollat dhe universitetet austro-hungareze⁵⁵.

Në zbatim të kësaj politike, në gusht të 1916-ës filloi rindërtimi i sistemit arsimor shqiptar nga ana e administratës ushtarake austro-hungareze. Objektivat kryesore ishin prodhimi i librave shkollorë në shqip, mënjanimi i gjuhëve sllave e italiane, mësimi i gjuhës gjermane krahas gjuhës shqipe dhe drejtimi i mësimin nga vendasit. Kështu, erdhën në jetë Drejtoritë e Përgjithshme të Arsimit, personeli i të cilave përbëhej nga shqiptarë, porse të gjitha vareshin nga komandat ushtarake përkatëse. Për përgatitjen e mësuesve të rinj dhe për kualifikimin e mësuesve ekzistues u projektua hapja e shkollave pedagogjike në Shkodër dhe në Elbasan⁵⁶. Pritej që masat e marra të luanin rolin kryesor në përhapjen e ndjenjës kombëtare tek shqiptarët dhe të revokonin traditën e ndjekur nga Austro-Hungaria për mbështetjen e shqiptarëve në fushën arsimore dhe kulturore⁵⁷.

Krahas Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit, me iniciativën e August Kral-it, miratuar me urdhrin e komandës së Korpusit të 19-të, më 30 qershor 1916 u themelua edhe Komisia Letrare Shqipe (KLSH), e cila e filloi veprimtarinë e saj, më 1 shtator.⁵⁸ Në përmbledhjen e dokumenteve të shpallura nga komanda e trupave austriakë në Shqipëri, për krijimin e saj, thuhej se KLSH kishte si detyrë “t’i shërbejë organizimit arsimor të ardhshëm dhe veçanërisht duhet të synojë t’i shërbejë zhvillimit të mëtejshëm nëpërmjet përmirësimit të gjuhës shqipe dhe njësimin të drejtshkrimit, krijimit të fjalëve të reja, botimit dhe

skicë-ideja e konsullit Kral për organizimin e territoreve shqiptare nën okupacionin austro-hungarez.

⁵⁵ *Po aty*.

⁵⁶ *HHSSt.A.P.A.A*, në *AIH*, Vj. 26-18-1805. Raport politik dhe administrativ i Komandës së Korpusit të 19-të për Kryekomandën e Ushtrisë në Teshen, Shkodër, 16 tetor 1916.

⁵⁷ Për më shumë në lidhje me rolin e Austro-Hungarisë në përhapjen e ndjenjës kombëtare shqiptare dhe të arsimit shqip shih: K. Gostentschnigg, “Kontributi i Austrisë (Austro-Hungarisë) për Shqipërinë e Veriut në fushën e arsimit”, në *Shkodra në shekuj*, Seminari i Pestë Ndërkombëtar (25-26 tetor 2002), Shkodër: Rozafa 01, 2005, f. 168-174.

⁵⁸ K. Gostentschnigg, “Krali kundër Pekmezit – Lufta në Komisinë Letrare Shqipe në Shkodër 1916–1918”, në *Shejzat* 1, nr. 3-4, Romë: 2016, f. 85–86.

korrektimit të librave”⁵⁹. Ajo kontrollonte në drejtim të një shprehjeje të njësuar dhe korrekte të gjitha dispozitat zyrtare të autoriteteve civile shqiptare dhe atyre ushtarake të huaja si dhe të gjitha publikimet zyrtare, librat shkollorë etj., përpara se këto të shkonin për shtyp.

Politika e mësipërme u shoqërua me hapjen masive të shkollave shqipe në Kosovë, veprim ky që konsiderohej me të drejtë si i rëndësishëm për forcimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve, të ardhmen e tyre politike dhe mbajtjen larg të propagandave të huaja. Sipas të dhënave u hapën shkolla fillore 4-vjeçare publike në rreth 20 qytete e fshatra, si në Pejë, Gjakovë, Gjurakovc, Irzniq, Istog, Mitrovicë, Llaushë, Vushtri etj. Ato ndiqeshin nga rreth 2.500 nxënës. Në këto shkolla përveç gjermanishtes që mësohej si lëndë e veçantë, të gjitha lëndët e tjera mësoheshin në gjuhën shqipe. Trupa mësimore u plotësua nga mësues të arsimuar në shkollat e Perandorisë Osmane, të cilët me kurse të shpejta, përvetësuan alfabetin e shqipes, si dhe me ish nxënës të Normales së Elbasanit⁶⁰.

Krahas shkollave laike në gjuhën shqipe, në kuadër të Kultusprotektoratit, Perandoria Dualiste vazhdoi të financonte edhe shkollat fetare katolike në Kosovë, siç ishte shkolla për djem dhe për vajza në Prizren, të cilën e furnizonte me të gjitha mjetet e nevojshme për funksionimin e saj. Mbështetje iu dha edhe shkollës së famullisë katolike në Ferizaj, në Zym të Hasit dhe në Stubëll e Letnicë të Vitisë. Në saje të mbështetjes së dhënë dhe librave të dërguar, dalëngadalë u arrit që mësimi të merrte përmbajtje kombëtare, ndërsa mësuesit të shijonin liri në mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të mësimdhënies. Përgjatë harkut kohor 1915-1918, në zonën austro-hungareze në Kosovë vepruan mbi 50 shkolla në gjuhën shqipe, në të cilat u edukuan dhe arsimuan rreth 4.000 nxënës shqiptarë⁶¹.

⁵⁹ Tomor Osmani, *Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918) dhe Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip (1879), Shoqëria "Bashkimi" (1899), Shoqëria "Agimi" (1901)*, Shkodër: Camaj-Pipa, 2009, f. 38.

⁶⁰ *Historia e shqiptarëve...*, f. 502.

⁶¹ Sipas studiuësit Fitim Rifati shkolla kishte në Gjakovë (840 nxënës), Pejë (700 nxënës), Bec, Bardosan, Brovinë, Gllogjan, Junik, Voksh, Irzniq, Dushkajë, Cërmjan, Drenoc, Pobergjë, Lloçan, Hulaj, Sllup, Zhur, Strellc i Epërm, Runik (Skënderaj), Rezallë, Polac, Llaushë, Klinë e Epërme, Tërstenik, Gllogoc, Mitrovicë (776 nxënës nga të cilët 268 vajza), Zhabar, Balincë, Smrekonicë, Pantinë, Novolan, Vllahi, Broboniq, Banjskë, Kçiç, Zasellë, Suhadoll, Vinarc, Koshtovë, Soçanicë, Borçan (Leposaviq), Ferizaj, Zym, Prizren, Vushtri, Gjurakoc, Baran, Zllakuqan, Istog,

Shqiptarët dhe administrata austro-hungareze e pushtimit

Studiuesja Tamara Cheer është e mendimit se në përgjithësi administratat e pushtimit e kanë shumë të vështirë që të plotësojnë qëllime pozitive në trajtimin e popullsisë. Pa anashkaluar këtu udhëzimet që oficerët perandorakë merrnin nga eprorët e tyre për t'u treguar të devotshëm në mbështetjen e tyre për popullatën shqiptare, jo gjithmonë ndodhte kështu. Në kushte lufte regjimet e pushtimit jo domosdoshmërisht bazoheshin në planet e paraluftës, ku rolin kryesor e luante diplomacia. Dominuese ishin kryesisht përvojat ushtarake dhe nevojat e ditës të ndikuara nga ecuria e luftës⁶².

Ndonëse pritshmëritë e shqiptarëve për politikën habsburgase ishin të larta, duke nisur nga pranvera e 1916-ës pakënaqësitë e tyre mbi administratën e pushtimit dolën në sipërfaqe. Shenjat e pakënaqësisë kishin të bënin me shprehjet e kohëpaskohshme të oficerëve austro-hungarezë ndaj shqiptarëve, për ndarjen e Shqipërisë dhe bashkimin e veriut të saj me Austro-Hungarinë, mungesën e një qasjeje miqësore nga përfaqësuesit e administratës ushtarake ndaj një vendi e populli mik të pushtuar, që manifestohej me abuzime në çështje tregtare, të shitblerjes, të rekuizimeve të kafshëve bartëse dhe të parmendës veçanërisht në zonat malore, të detyrimit të popullsisë për të paguar me flori blerjen e drithit dhe të produkteve ushqimore, zbatimi i një varg masash të ashpra me rastin e rekrutimit të detyrueshëm dhe trajtimit ushtarak të shqiptarëve, pa anashkaluar edhe qëndrimin aspak miqësor që administrata ushtarake mbajti ndaj ankimeve të popullsisë, të cilat sipas komandës së Korpusit të 19-të që në mars të 1916-ës kishin marrë formën e një lumi që vazhdimisht vinte duke u fryrë⁶³.

Mungesa e konsideratës së autoriteteve ushtarake austro-hungareze, kryesisht me kombësi sllave, për veçoritë kombëtare dhe fetare të shqiptarëve, ishte një tjetër aspekt i dhunës formale që solli rritjen e zemëratës së këtyre të fundit. Nga relacionet që vinin nga terreni raportoheshin vazhdimisht rastet, ku oficerët me kombësi sllave tentonin

Rakosh, Strallë, Budisalc (komuna e Klinës) etj. F. Rifati, *Kosova gjatë Luftës së Parë Botërore ...*, tezë doktrature, e pabotuar.

⁶² T. Cheer, "Politika okupuese habsburgase ndaj shqiptarëve ...", f. 219.

⁶³ Ledia Dushku, "Shqiptarët përballë ushtarakëve dhe diplomatëve austro-hungarezë", në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2017, f. 81.

t'u përdhosnin shqiptarëve zakonet dhe veçoritë kombëtare. Në rritjen e pakënaqësisë ndikoi edhe ashpërsia me të cilën reagonin autoritetet austro-hungareze ndaj çdo rezistence që cenonte rendin. Në këtë kuadër pati me dhjetëra persona të internuar në kampet e përqendrimit në Hungari, pati burgosje dhe internime të familjeve të kaçakëve që refuzonin të dorëzoheshin, gjithashtu konfiskime të tokës dhe pasurisë së tyre⁶⁴. Nuk duhen anashkaluar edhe sjelljet imponuese dhe papërshtatshmëria mbi trajtimin politik të krerëve të shquar shqiptarë, si në aspektin e dënimeve (internime, konfiskime) dhe atë të favorizimeve (emërimeve).

Në dobi të amortizimit të pakënaqësisë dhe ruajtjes së besnikërisë së shqiptarëve, nga terreni vinin kërkesa që të bëheshin ndryshime të nevojshme në administratën ushtarake dhe emërime të personave që shprehnin dashuri dhe respekt për vendin dhe banorët e tij. Krahas kësaj, për të devijuar dobësitë e administratës ushtarake, kërkoheshin edhe zgjerimi i kompetencave të përfaqësuesve civil në administratë.⁶⁵

Situata e vështirë e krijuar në terren nxiti mjaft shqiptarë myslimanë, të cilët të stimuluar edhe nga ndjenja simpatie për Perandorinë Osmane, u shpërngulën nga zona austro-hungareze në drejtim të shtetit osman. Motivët dhe përmasat e shpërnguljeve nuk ishin si ato në vitet 1912-1915, ose si ato në zonën bullgare, por gjithsesi do të linin pasojë në ekonomi, në marrëdhëniet e pronësisë, e mbi të gjitha në situatën demografike dhe etnike në Kosovë⁶⁶.

Nga ana tjetër, si rezultat i ashpërsisë së përdorur nga autoritetet ushtarake austro-hungareze filloi të shfaqej reagimi i armatosur i shqiptarëve. Dallohet këtu çeta e drejtuar nga Mulla Agan Kaja, i graduar oficer nga austro-hungarezët, e cila në vitin 1917 organizoi atentatin kundër komandantit lokal austro-hungarez, i njohur për qëndrimin armiqësor ndaj shqiptarëve⁶⁷. Në kushtet kur Luftës së Parë Botërore po i vinte fundi, zhgënjimi i shqiptarëve karshi Austro-Hungarisë mori përmasa ekstreme, çka u shoqërua edhe me forma të bashkëpunimit të tyre me serbët. Ndërsa, më 1 tetor 1918 austro-hungarezët urdhëruan

⁶⁴ Liman Rushiti, *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1913-1918*, Instituti i Historisë: Prishtinë, 1986, f. 187-190; *Historia e shqiptarëve....*, f. 503-504.

⁶⁵ *HHSSt.A.P.A.A.*, në *AIH*, Vj. 26-19-1937. Rezervat i Vizner pranë Kryekomandës së ushtrisë, Vjenë, 25 gusht 1916.

⁶⁶ L. Rushiti, *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë...*, f. 187-190; *Historia e shqiptarëve....*, f. 503-504.

⁶⁷ *Historia e shqiptarëve....*, f. 507.

tërheqjen e trupave të tyre, çetat serbe hynë në Pejë njëherësh me çetat shqiptare të Azem Galicës që kishin çliruar Drenicën dhe një pjesë të Rrafshit të Dukagjinit. Historia do të përsëritej, por, tashmë në krah të kundërt: shqiptarët njësoj sikurse kishin vepruar tre vite më parë kundër serbëve dhe malazezëve, në mbështetje të trupave austro-hungarezë, në tetor të 1918-ës do të luftonin forcat e Aleancës Qendrore duke hapur kështu korridorin për depërtimin e forcave të Antantës në Kosovë⁶⁸. Duke shpresuar në bashkëpunimin me Antantën për realizimin e bashkimit kombëtar, ata i dhanë mbështetje ardhjes së trupave franceze. Koha tregoi se francezët kishin ndjekur karshi tyre veçse një politikë demagogjike dhe brenda muajit tetor ato ia lanë vendin trupave ushtarakë serbë, të cilat nisën çarmatimin e dhunshëm të popullsisë⁶⁹. Ripushtimi i Kosovës u bë kështu sërish realitet.

S u m m a r y

THE AUSTRO-HUNGARIAN POLICY IN RELATION TO KOSOVO DURING THE FIRST WORLD WAR

The Austro-Hungarian policy in relation to Kosovo was directly influenced by the attitude towards Serbia and Albania. Politically Kosovo was included in the former while the Kosovo Albanians continuously aspired to join the latter. Against this background took place the Austria-Hungarian invasion of Kosovo and in agreement with Bulgaria was carried out the civil and military administrative division of the occupied area between the two powers.

A specific characteristic was that the territory of Kosovo was divided among three different administrative units: Albania, Serbia and Montenegro, which in their turn had already been occupied by Austro-Hungary. The primary goal of the occupation regime in Kosovo, along with maintaining order and

⁶⁸ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)*, Fondi “Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, Dosja 39, fl. 33. Pushtimi dhe ripushtimi serb i Kosovës, 1912-1918.

⁶⁹ Për më shumë në lidhje me depërtimin e forcave të Antantës në Kosovë dhe qëndrimin e shqiptarëve shih: Hakif Bajrami, “Si e riokupoi Serbia Kosovën më 1918”, në *Vjetari*, nr. XXXVII-XXXVIII, Prishinë: 2007; Izber Hoti, “Peja me rrethinë në fund të vitit 1918 mbështetur në të dhënat serbe”, në *Kosova*, nr. 28, Prishtinë: 2006.

tranquility, was to provide recruits for the advanced frontlines and to make use as much as possible of the economic resources of the region.

In order to preserve the traditional affinity of the Albanians for Austro-Hungary, the military authorities encouraged and pressed by the diplomatic circles, allowed the appointment of native officials in the local administration and followed a policy in favor of the national cultural autonomy. This policy was more evident especially in the territory defined by the administrative borders of the 19th Command Corpus for Albania.

Despite the Albanians high expectations for the Habsburg policy, their dissatisfaction with the occupation administration began to emerge since spring 1916. The first signs of discontent were caused by the frequent statements of the Austro-Hungarian officers for the partition of Albania and the inclusion of the North into the Austro-Hungarian empire, an unfriendly attitude of the military administration and because of the policy of recruitments and requisitions. Against this backdrop, the immigration to the Ottoman Empire grew in numbers, the armed resistance of the Albanians intensified and the support for the Entente powers increased.

